

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot më datën 21.3 2002, unë gjyqtarja e Gjykatës së rrethit Tiranë, pasi studjova kërkesën e dokumentat e paraqitura nga kërkuesi Bardhok Lleshi, për regjistrimin si person juridik

K O N S T A T O V A :

Bardhok Lleshi, me cilësinë e administratorit dhe te përfaqshesuesit ligor të shoqërisë ka paraqitur kërkesë për regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MILENIUM CONSTRUCTION SH.P.K.", me seli në Tirane (Shqipëri), në Rrugën "Mihal Grameno" perballë mini Bashkise dhe kapital shoqëror 100.000 lekë. Shoqeria ka për objekt:**Ndertime civile dhe ekonomike**, Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, e te tjere, mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. **Prodhime Materiale Ndertimi**: Prodhim materiale inerte, rere cakull, gure, mermer etj. Prodhim qeramike si tulla tjegulla, fajance, gres. Prodhim elementesh te parafabrikuara, betoni e b/arne. Prodhim elemetesh te parendur dhe armocementi. Prodhim materiale lidhese çimentoje, gelqereje, allçi etj. Prodhime materiale bituminoze si kartone, katrama, pasta, astika bituminoze, asfalto betone etj. Prodhime druri metalike, plastike etj, per dyer, dritare, kallepe, etj.

Punime restaurimi Rikonstruksione godinash civile e ekonomike veshje fasadash etj. Restaurim I monumenteve te kultures .

Punimet e montimit dhe teknologjike Montimi dhe instalimi I makinerive dhe impianteve ngritese e transportuese (vinça ,teleferike , transportiere , shkalle levizese , ashensore etj) dhe mirembajtja e tyre .Montimi dhe instalimi I impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre .Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike , kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre .Montimi dhe instalimi I impianteve pneumatike te sigurimit te kontrollit (KIP) dhe mirembajtja e tyre .Punime me metal , dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike.Punime bojatisje ,hidroizolimi, termoizolimi , akustike e kundra zjarrit te impianteve teknologjike .Montimi dhe instalimi I impianteve te gazit dhe I eneve me presion si dhe mirembajtja e tyre .**Punimet e montimit ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise**.Impiante per prodhim energjie alternative, impiante elektrike per nëstacionet dhe kabinet e transformatoreve , impiante dhe linja elektrike, telefoni, radio-telefoni, televiziv, citofoni, dhe mirembajtjen e tyre, linja te tensionit te larte(TL) , linja te tensionit te ulet (TU) e te mesem , aparatura elektrike dhe mirembajtja e tyre , punime kolaudimi per pajisjet primare e sekondare elektrike dhe per kolaudime mekanike per nëstacione dhe centrale elektrike .**Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtje** .Punime ne siperfaqet e gjelberta , parqe,pyll-pastrim I siperfaqes urbane , kryerja e sherbimeve me sherbesa funerale,-mirembajtja dhe zhvillimi I dekorit ne njedise urbane.**Prodhimin e artikujve te veshmbathjes e te tjera te ngjashme**, te te gjitha llojeve e cilësive, pa kufizim destinacioni, për llogari te saj apo tip fason, duke punuar me materiale jo te saj; Te gjitha keto aktivitet shoqeria do ti kryej me materiale te saj

dhe jo te saj .

Importimin e tregtimin e lendeve te para e prodhimeve te perfunduara duke përfshirë tregtimin e tyre në të gjithë gamën e llojshmërisë së tyre të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi; Trasporti për nevojat e shoqërisë dhe të tretëve ; Kryerja e operacioneve me pasuri të palujtëshme: blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjetër të pasurive të palujtëshme në funksion të realizimit të qëllimeve shoqërore si dhe sipërmarrje të ndryshme, në përputhje me kërkesat që burojnë nga ligjet në fuqi. Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren. Ortakët e shoqërisë janë Bardhok Preng Lleshi 50% të kapitalit shoqëror ose 50.000 lekë; dhe Martin Preng Lleshi 50% të kapitalit shoqëror ose 50.000 lekë; Shoqëria administrohet nga Bardhon Lleshi me të drejtë firme e përfaqsimi të shoqërisë . Kohëzgjatja e shoqërisë është fiksuar deri në 31 dhjetor të vitit 2012, veç shfuqizimit apo zgjidhjes së parakohshme.

Nga shqyrtimi i dokumentave rezulton se kërkesa është e bazuar në ligj e si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të dispozitave të ligjit Nr. 7638 e 7676,

V E N D O S A :

Pranimin e kërkesës. Regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MILENIUM CONSTRUCTION SH.P.K.", me seli në Tirane (Shqipëri), në Rrugën "Mihal Grameno" perballë mini Bashkise dhe kapital shoqëror 100.000 lekë. Shoqeria ka për objekt:**Ndertime civile dhe ekonomike**, Ndertime civile, industriale , turistike , bujqesore , e te tjere , mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to .**Prodhime Materiale Ndertimi** :Prodhim materiale inerte , rere cakull , gure , mermer etj. Prodhim qeramike si tulla tjegulla, fajance , gres. Prodhim elementesh te parafabrikuara , betoni e b/arne. Prodhim elemetesh te parendur dhe armocementi. Prodhim materiale lidhese çimentoje , gelqereje, allçi etj. Prodhime materiale bituminoze si kartone, katrama, pasta, astika bituminoze, asfalto betone etj. Prodhime druri metalike, plastike etj, per dyer , dritare, kallepe, etj.

Punime restaurimi Rikonstruksione godinash civile e ekonomike veshje fasadash etj. Restaurim I monumenteve te kultures .**Punimet e montimit dhe teknologjike** Montimi dhe instalimi I makinerive dhe impianteve ngritese e transportuese (vinça ,teleferike , transportiere , shkalle levizese , ashensore etj) dhe mirembajtja e tyre .Montimi dhe instalimi I impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre .Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike , kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre .Montimi dhe instalimi I impianteve pneumatike te sigurimit te kontrollit (KIP) dhe mirembajtja e tyre .Punime me metal , dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike. Punime bojatisje , hidroizolimi, termoizolimi , akustike e kundra zjarrit te impianteve teknologjike .Montimi dhe instalimi I impianteve te gazit dhe I eneve me presion si dhe mirembajtja e tyre .**Punimet e montimit ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.** Impiante per prodhim energjie alternative, impiante elektrike per nistacionet dhe kabinet e transformatoreve , impiante dhe linja elektrike, telefoni, radio-telefoni, televiziv, citofoni, dhe mirembajtjen e tyre, linja te tensionit te larte(TL) , linja te tensionit te ulet (TU) e te mesem , aparatura elektrike dhe mirembajtja e tyre , punime kolaudimi per pajisjet

primare e sekondare elektrike dhe per kolaudime mekanike per nistacione dhe centrale elektrike .**Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtje** .Punime ne siperfaqet e gjelberta , parqe,pyll-pastrim I siperfaqes urbane , kryerja e sherbimeve me sherbesa funerale,-mirembajtja dhe zhvillimi I dekorit ne mjedise urbane.**Prodhimin e artikujve te veshimbathjes e te tjera te ngjashme**, te te gjitha llojeve e cilësive, pa kufizim destinacioni, për llogari te saj apo tip fason, duke punuar me materiale jo te saj; Te gjitha keto aktivitet shoqeria do t'i kryej me materiale te saj dhe jo te saj .**Importimin e tregtimin e lendeve te para e prodhimeve te perfunduara** duke përfshirë tregtimin e tyre në te gjithë gamën e llojshmërisë së tyre te lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi;Trasporti për nevojat e shoqërisë dhe te tretëve ; Kryerja e operacioneve me pasuri te palujtëshme: blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjeter te pasurive te palujtëshme në funksion te realizimit te qëllimeve shoqërore si dhe sipërmarrje te ndryshme, në përputhje me kërkesat që burojnë nga ligjet në fuqi. Shoqëria me qëllim te arritjes së objektivave shoqërore mund te marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri te tjera shqiptare ose te huaja që kanë objekt analog ose te lidhur me te tyren. Ortakët e shoqërisë janë Bardhok Preng Lleshi 50% te kapitalit shoqëror ose 50.000 lekë; dhe Martin Preng Lleshi 50% te kapitalit shoqëror ose 50.000 lekë; Shoqëria administrohet nga Bardhok Lleshi me te drejtë firme e përfaqsimi te shoqërisë .

Kohëzgjatja e shoqërisë është filksuar deri në 31 dhjetor te vitit 2012, veç shfuqizimit apo zgjidhjes së parakohshme.

Kundër këtij vendimi mund te bëhet ankim në shkallë te dyte.

Tiranë, më 21.3. 2002

G J Y Q T A R E
Naimanda Dafa
Dafa

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 27430/Vendimit**

VENDIM
LGJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date ~~27.04.2004~~ une Mariana Dedi Gjyqetare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura nga:

KERKUES: Edison Prendi, me cilesine e administratorit te Shoq “Millenium Construcion” sh.p.k.

KONSTATOVA:

Me vendimin nr 27430 dt 21.03.2002 eshte bere rregjistrimi si person juridik I Shoqerise “Millenium Construcion” sh.p.k.

Me vendimin nr 1 te dt 25.02.2004 te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur:

1. Largimi nga detyra i administratorit Z.Bardhok Lleshi te shoq “Millenium Construcion” shpk.
2. Emerimi i Z.Edison Prendi ne detyren e administratorit te shoq ‘Milenium Construcion” shpk
- 3.Miratimi I shitjes se 25% kuoteve nga Bardhok Preng Lleshi qe zoteronte 50% te kapitalit shoqeror te barabarte me 50.000 lek, tek Ndrek Lleshi, I cili pas blerjes sipas kontrates notoriale bashkengjitur dhe miratimit tone me kete vendim, zoteron 25% te kapitalit shoqeror, te barabarte me 25.000 leke, dukle u bere ortaku I ri I shoqerise.

Nga ky moment ortaket e shoqerise “Millenium Construcion” shpk jane:

1. Martin Lleshi me 50% te kuotave barabarte me 50.000 leke
2. Bardhok Lleshi me 25% te kuotave te barabarte me 25.000 leke
- 3.Ndrek Lleshi me 25% te kuotave te barabarte me 25.000 leke

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore, cmoj se ajo duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :


Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.ll.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "Per Regjistrimin ne Regjistrin Tregtar"

V E N D O S A :

Depozitimin e vendimit nr 1 dt 25.02.2004 te mbledhjes se asamblese se ortakeve te shoqerise "Millenium Construcion" shpk

-Te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen reshtin

Tirane ,me 22.04.2004

G J Y O T A R E

MARIANA DEDI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 27430/2

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me dt 03.03. 2005, une, Gjyqtarja A. Caco, Gjyqetare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit Edison Prendi, administrator i "Millenium Construcion" sh.p.k..

KONSTATOVA

Se me Vendimin nr.27430 date 21.03.2002 eshte rregjistruar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane shoqeria "Millenium Construcion" sh.p.k.. Me vendimin nr. 27430/1 date 02.04.2004 ortake te shoqerise jane :Martin Lleshi, Bardhok Lleshi dhe Ndrec Lleshi.

Me Vendimin nr. 2 date 18.02.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise eshte vendosur:

1. Miratimi ne unanimitet i shitjes se te gjithe kuotes se kapitalit prej 25% ne vlore 25.000 leke te Ortakut Bardhok Lleshi Znj. Ardit Prendi .
2. Zevendesimi i ortakut Bardhok Lleshi me Ortaken e re Ardit Prendi.
3. Depozitimin e ketij ndryshimi ne Zyren e Rregjistrat Tregetar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7638, dt 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare" dhe atij nr. 7667, dt 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar"

VENDOSA

Depozitimin ne Rregjistrin Tregetar te Vendimit nr. 2 date 18.02.2005 te Asamblese se Ortakeve te "Millenium Construcion"sh.p.k..

-Te ndahen rregjistrimet nga njeri-tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen.....reshtin.....

Tirane me 03.-03- 2005

GJYQTARE

Ariane Caco
A.C.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Vendimi nr. 27430 /3

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 17/2/2006, une M. Reppa, Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria "Millenium Construction" Shpk., per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Shpk., date 17.01.2006, dhe dokumenteve te tjera perkatese nga te cilet:

KONSTATOVA:

Shoqeria Millenium Construction Shpk., nje shoqeri me perqejjesi te kufizuar, e regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar, me vendimin nr. 27430 date 03.03.2005.

Me vendimin e dates 17.01.2006 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Sh.p.k., ka vodosur:

1. Ndryshimin e selise se shoqerise Millenium Construction Shpk., ne Lgj. Beslidhja, Rr. Kosova, Pll. 73, Lezhe;
2. Te autorizoj Av. Gedeon Dudushi per perqatitjen e kerkeseve dhe ndjekjen e procedurave per depozitimin e ketij vendimi ne Zyren e Rregjistrat Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Gjithashtu konstatova se kerkesa per regjistrimin e faktit te mesiperme dhe depozitimin e akteve perkatese ne regjistrin tregtar, eshte e bazuar ne ligj, dhe

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeseve.

Depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Sh.p.k te dates 17.01.2006;

Urdherohet zyra e Regjistrat Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen ___, germa ___ si dhe te behet ndarja nga njeri-tjetri me vize te kuqe.

GJYOTARE
Majlinda Dafa

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Vendimi nr. 27430 /15

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 05/07/2006, une Asamblea e Jashtezakonshme te Ortakeve te Shoqerise "Millenium Construction" Shpk. gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria "Millenium Construction" Shpk., per depozitimin e vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Shpk., date 15.06.2006, dhe dokumenteve te tjera perkatese nga te cilet:

KONSTATOVA:

Shoqeria Millenium Construction Shpk., nje shoperi me perjegjesi te kufizuar, e regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar, me vendimin nr. 27430 date 03.03.2005.

Asambleja e jashtezakoshme e ortakeve te shoqerise me vendimin date 15.06.2006 ka vendosur si me poshte:

1. Miratimin dhe urdherimin e pasqyrimit te ndryshimit te emerit te ortakut David Lleshi i cili ka patur emrin Martin Lleshi dhe e ka ndryshuar me vendimin e komunes Gjegjan nr. 32 date 17.04.2002.
2. Konfirmimin dhe miratimit e vendimit te asamblese se ortakeve te dates 25.02.2004 ne lidhje me largimin e Z. Bardhok Lleshi nga detyra e administratorit te shoqerise, emerimin e Z. Edison Prendi ne detyren e administratorit, miratimin e ortakeve per shitjen e kuotave nga ortaku Bardhok Lleshi tek ortakut i ri Ndrek Lleshi zoterues i 25% te kuotave.
3. Konfirmimin e miratimit te vendimit te asamblese se ortakeve te dates 18.02.2005 per miratimin e shitjes se kuotave nga ortaku Bardhok Lleshi tek Znj. Aferdita Prendi qe behet ortake e re zoteruese e 25% te Kuotave te shoqerise.
4. Konfirmimin e miratimit te vendimit te asamblese se ortakeve te dates 17.01.2006 per ndryshimin e selise se shoqerise Millenium Construction Shpk., ne Lgj. Beslidhja, Rr. Kosova, Pll. 73, Lezhe;

5. Konfirmimin e miratimit te vendimit te asamblese se ortakeve te 15.05.2006 ne lidhje me shkarkimin e administratorit te shoqerise Edison Prendi dhe emerimin e Z. David Lleshi si administrator i shoqerise.
6. Te autorizoj Av. Gedeon Dudushi per pergatitjen e kerkeses dhe ndjekjen e procedurave per depozitimin e ketij vendimi ne Zyren e Rregjistrat Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Gjithashtu konstatova se kerkesa per regjistrimin e faktit te mesiperm dhe depozitimini e akteve perkatese ne regjistrin tregtar, eshte e bazuar ne ligj, dhe

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimini e vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Sh.p.k te dates 16.06.2006;

Urdherohet zyra e Regjistrat Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen ___, germa ___ si dhe te behet ndarja nga njeri-tjetri me vize te kuqe.

GJYQTARE

Ariana Gurakuqi (caco)


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Vendimi nr. 27430 /6

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 12/04/2007, une Mariam Sheqani (Nedj)
Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria "Millenium Construction" Shpk., per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Shpk., date 26.02.2006, dhe dokumenteve te tjera perkatese nga te cilet:

KONSTATOVA:

Shoqeria Millenium Construction Shpk., nje shoqeri me perqegjesi te kufizuar, e regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar, me vendimin nr. 27430 date 03.03.2005.

Me vendimin e dates 26.02.2006 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Sh.p.k., ka vndosur:

1. Largimin me kerkesen e saj nga shoqeria te Ortakes, Znj. Ardita Prendi
2. Shitjen teresisht te kuotave nga Znj. Ardita Prendi dhe blerjen e tyre nga Z. Ndrek Lleshi.
3. Pas ndryshimeve te mesiperme, Shoqeria Millenium Construction shpk, ka dy ortak, Z. David Lleshi dhe Z. Ndrek Lleshi, te cilet zoterojne perkatesisht:
 - Ortaku David Lleshi zoteron 50% te kuotave te shoqerise te barabarta me 50% te kapitalit te saj ;
 - Ortaku Ndrek Lleshi zoteron 50% te kuotave te shoqerise te barabarta me 50% te kapitalit te saj
4. Te autorizoj Av. Gedeon Dudushi per perqatitjen e kerkeseve dhe ndjekjen e procedurave per depozitimin e ketij vendimi dhe te kontrates se shit-blerjes se kuotave nr. 467 Rep., Nr. 116 Kol date 26.02.2007 ne Zyren e Rregjistrat Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Gjithashtu konstatova se kerkesa per regjistrimin e faktit te mesiperme dhe depozitimin e akteve perkatese ne regjistrin tregtar, eshte e bazuar ne ligj, dhe

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Registrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Millenium Construction" Sh.p.k te dates 26.02.2007;

Largimin me kerkesen e saj nga shoqeria te Ortakes, Znj. Ardita Prendi

Shitjen teresisht te kuotave nga Znj. Ardita Prendi dhe blerjen e tyre nga Z. Ndrek Lleshi.

Pas ndryshimeve te mesiperme, Shoqeria Millenium Construction shpk, ka dy ortak, Z. David Lleshi dhe Z. Ndrek Lleshi, te cilet zoterojne perkatesisht:

- a. Ortaku David Lleshi zoteron 50% te kuotave te shoqerise te barabarta me 50% te kapitalit te saj ;
- b. Ortaku Ndrek Lleshi zoteron 50% te kuotave te shoqerise te barabarta me 50% te kapitalit te saj

Urdherohet zyra e Regjistrat Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen ___, germa ___ si dhe te behet ndarja nga njeri-tjetri me vize te kuqe.

GJYQTARE

Mariama Sheqani (Dedi)


m

URDHËR REGJISTRIMI

Kolona I	Numri i Regjistrat Tregtar: <u>27430</u>
Kolona II	<p>A. Emri i Shoqërisë: <u>Milemilia Construction S.p.c</u> B. Selia: <u>Pershmeti pr. M. Pashemi</u> C. Objekti: <u>C. Nohetum Gjilani - Peshmena e Peshmenit, peshmenit, peshmenit, peshmenit e folkloristikës, etj</u> D. Kapitali: <u>100.000 Lek</u></p>
Kolona III	<p>A. Ortakët <u>Bardhek Lleshi</u> <u>Martim Lleshi</u></p> <p>B. Administratorët: <u>Bardhek Lleshi</u></p>
Kolona IV	Kohëzgjatja: <u>10 vjet</u>
Kolona V	<p>Shënime mbi aktet e shoqërisë:</p> <p>A. Data e Nënshkrimit: <u>18/3/2002</u> B. Data e regjistrimit: <u>21.3.2002</u> C. Statuti fletë: <u>8 fletë</u> D. Akti i Themelimit fletë <u>4 fletë</u></p>

Shënime: Vrejtetur, B. Fushinave
C.N. 01/0000 10252 d.t 18.3.2002 (shundiç, fragtali)

GJYKATARE


AKT THEMELIMI



Sot me date 05.03. 2002 , ne Tirane , ne anetaret themelues , me cilesine e ortakeve,

1. Bardhok Preng Lleshi
2. Martin Preng Lleshi

Vendosem dhe nenshkruam sa vijon :

NENI 1

Te krijoje nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar nen emertimin shoqeror **"MILENIUM CONSTRUCTION" SH.P.K .**

NENI 2

Shoqeria e ka **seline** ligjore ne Tirane ne Rr. "Mihal Grameno", perballë mini Bashkise dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise e jashte saj ne perputhje me ligjet e vendit.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte fiksuar deri ne 31 Dhjetor 2012 , veç shfuqizimit apo zgjidhjes se parakohshme .

NENI 4

Shoqeria ka si **objekt** te saj :-

Ndertime civile dhe ekonomike ,

- Ndertime civile, industriale , turistike , buqesore , e te tjere , mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to .

Prodhime Materiale ndertimi :

- a) Prodhim materiale inerte , rere cakull , gure , mermér etj.
- b) Prodhim qeramike si tulla tjegulla, fajance , gres.
- c) Prodhim elementesh te parafabrikuara , betoni e b/arne.
- d) Prodhim elemetesh te parendur dhe armocementi.
- e) Prodhim materiale lidhese çimentoje , gelgereje, allçi etj.

Bardhok Lleshi -1- *Martin Lleshi M-Len*

f) Prodhime materiale bituminoze si kartone, katrama, pasta, astika bituminoze, asfalto betone etj.

g) Prodhime druri metalike, plastike etj, per dyer , dritare, kallepe, etj.

Punime restaurimi

a) Rikonstruksione godinash civile e ekonomike , veshje fasadash etj.

b) Restaurim I monumenteve te kultures .

Punimet e montimit dhe teknologjike

- Montimi dhe instalimi I makinave dhe impianteve ngritesë e transportuese (vinça ,teleferike , transportiere , shkalle levizese , ashensore etj) dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike , kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve pneumatike te sigurimit te kontrollit (KIP) dhe mirembajtja e tyre .
- Punime me metal , dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike.
- Punime bojatisje ,hidroizolimi, termoizolimi , akustike e kundriza jarrit te impianteve teknologjike .
- Montimi dhe instalimi I impianteve te gazit dhe I eneve me presion si dhe mirembajtja e tyre .

Punimet e montimit ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.

- Impante per prodhim energjie alternative, impiante elekrike per n\stacionet dhe kabinet e transformatoreve , impiante dhe linja elekrike, telefoni, radio-telefoni, televiziv, citofoni, dhe mirembajtjen e tyre, linja te tensionit te larte(TL) , linja te tensionit te ulet (TU) e te mesem , aparatura elekrike dhe mirembajtja e tyre , punime kolaudimi per pajisjet primare e sekondare elekrike dhe per kolaudime mekanike per n\stacione dhe centrale elekrike .

Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtje .

- Punime ne siperfaqet e gjelberta , parqe ,pyll.- pastrimi I siperfaqes urbane ,- kryerja e punime ne sherbesa funerale, - mirembajtja

Borboleshka -1. Martin Lushni M. Lushni

dhe zhvillimi I dekorit ne mjedise urbane .

Prodhimin e artikujve të veshmbathjes e të tjera të ngjashme, të të gjitha llojeve e cilësive, pa kufizim destinacioni, për llogari të saj apo tip fason, duke punuar me materiale jo të saj;

Te gjitha keto aktivitet shoqeria do t'i kryej me materiale te saj dhe jo te saj .

Importimin e tregtimin e lendeve te para e prodhimeve te perfunduara duke përfshirë tregtimin e tyre në të gjithë gamën e llojshmërisë së tyre të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi;

Trasporti për nevojat e shoqërisë dhe të tretëve ;

Kryerja e operacioneve me pasuri të palujtëshme: blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjeter të pasurive të palujtëshme në funksion të realizimit të qëllimeve shoqërore si dhe sipërmarrje të ndryshme, në përputhje me kërkesat që burojnë nga ligjet në fuqi.

Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.

NENI 5

Kapitali shoqeror eshte 100 000 mijë leke (njeqindmije) I ndare ne kuota (pjese) si me poshte vijon:

Bardhok Preng Lleshi 50 000 leke ose 50% te kapitalit
Martin Preng Lleshi 50 000 leke ose 50% te kapitalit

Ortaket mund te financojne shoqerine per mbarvajtjen e aktivitetit shoqeror , duke lidhur mareveshjet perkatese ne formen e kerkuar nga ligji .

NENI 6

Kuotat e ortakeve do te rregistrohen ne librat kontabel dhe ne librin e ortakeve .

Kapitali nenshkruehet e derdhet sipas ligjit .

Bardhok Lleshi, M. Len -1- *Martin Lleshi M. Len*



NENI 7

Fitimi neto do te ndahet midis ortakeve ne perputhje me perqindjen e kuotave qe posedon secili prej tyre ne kapitalin shoqeror.

NENI 8

Shoqeria administrohet nepermjet organeve te saj qe janë :

- Asambleja e ortakeve ;
- Administratori I vetem
- Ekspert kontabel te autorizuar ne rastet e parashikuara ne nenin 65 te ligjit numer 7638 .

Funksionet e modalitet e formimit te tyre percaktohen ne statutin e shoqerise .

Neni 9

Shoqeria administrohet nga nje **administrator** me te drejte firme e perfaqesimi.

Administrator emerohet Bardhok Preng Lleshi.

Administratori perfaqeson shoqerine me te tretet.

Personi I mesiperme e pranon detyren duke deklaruar se nuk gjendet para asnje prej kushteve te pazgjedhshmerise parashikuar ne ligj .

NENI 10

Viti I pare ushtriror mbylljet me 31 Dhjetor 2002 .

NENI 11

Aktet e shoqerise redaktohen ne gjuhen shqipe .

Cdo kerkese tjeter e shoqerise se mesiperme specifikohet ne statutin e shoqerise te perbere nga 27 nene , qe palet pasi e kane lexuar e diskutuar duke deklaruar se e njohin mire , e aprovojne dhe firmosin ne prezence te noteres duke ja bashkelidhur ketij akti nen german "b".

ORTAKET THEMELUES

Bardhok Lleshi
Martin Lleshi Malem

“B” BASHKËLIDHUR AKTIT TË THEMELIMIT

STATUTI

KAPITULLI I

Emërtimi - Selia - Jetëgjatësia

Neni 1 - Themelimi

Është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “MILENIUM CONSTRUCTION SH.P.K.” mbi bazën e aktit të themelimit.

Neni 2 - Selia

Shoqëria e ka selinë ligjore në Tirane Rrg. " Mihal Grameno", perballe mini Bashkise.

Neni 3 - Selia sekondare

Asambleja e jashtëzakonshme mund të formojë seli sekondare ose t'i suprimojë ato, ndërsa organi administrativ mund të krijojë e suprimojë filiale, degë, agjensi dhe zyra përfaqsimi.

Neni 4 - Jetëgjatësia

Jetëgjatësia e shoqërisë është vendosur nga data e krijimit deri 31 dhjetor te vitit 2012 përvèç shfuqizimit ose zgjidhjes së parakohshme.

KAPITULLI II

Objekti

Neni 5-Objekti e qëllimet shoqërore

Shoqëria ka për objekt:

- , **Ndertime civile dhe ekonomike** ,
- Ndertime civile, industriale , turistike , bujqesore , e te tjere , mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to .

Prodhime Materiale ndertimi :

- a) Prodhim materiale inerte , rere cakull , gure , mermér etj.

Bardhës Shk. *[Signature]*

Martin Ushiqi M. Len

- b) Prodhim qeramike si tulla tjegulla, fajance , gres.
- c) Prodhim elementesh te parafabrikuara , betoni e b/arne.
- d) Prodhim elemetesh te parendur dhe armocementi.
- e) Prodhim materiale lidhese çimentoje , gelqereje, allçi etj.
- f) Prodhime materiale bituminoze si kartone, katrama, pasta, astika bituminoze, asfalto betone etj.
- g) Prodhime druri metalike, plastike etj, per dyer , dritare, kallepe, etj.

Punime restaurimi


- a) Rikonstruksione godinash civile e ekonomike veshje fasadash etj.
- b) Restaurim I monumenteve te kultures .

Punimet e montimit dhe teknologjike

- Montimi dhe instalimi I makinerive dhe impianteve ngritese e transportuese (vinça ,teleferike , transportiere , shkalle levizese , ashensore etj) dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike , kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve pneumatike te sigurimit te kontrollit (KIP) dhe mirembajtja e tyre .
- Punime me metal , dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike.
- Punime bojatisje ,hidroizolimi, termoizolimi , akustike e kundra zjarrit te impianteve teknologjike .
- Montimi dhe instalimi I impianteve te gazit dhe I eneve me presion si dhe mirembajtja e tyre .

Punimet e montimit ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.

- Impante per prodhim energje alternative, impiante elektrike per n\stacionet dhe kabinet e transformatoreve , impiante dhe linja elektrike, telefoni, radio-telefoni, televiziv, citofoni, dhe mirembajtjen e tyre, linja te tensionit te larte(TL) , linja te tensionit te ulet (TU) e te mesem , aparatura elektrike dhe mirembajtja e tyre , punime

Bordeka Sh. 

Martin Ureshi M. Len

kolaudimi per pajisjet primare e sekondare elektrike dhe per kolaudime mekanike per n\stacione dhe centrale elektrike .

Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtje .

Punime ne siperfaqet e gjelberta , parqe,pyll-pastrim I siperfaqes urbane , kryerja e sherbimeve me sherbesa funerale,-mirembajtja dhe zhvillimi I dekorit ne mjedise urbane.

- **Prodhimin e artikujve të veshmbathjes e të tjera të ngjashme**, të tē gjitha llojeve e cilësive, pa kufizim destinacioni, pér llogari të saj apo tip fason, duke punuar me materiale jo të saj;

Te gjitha keto aktivitet shoqeria do t'i kryej me materiale te saj dhe jo te saj .

Importimin e tregtimin e lendeve te para e prodhimeve te perfunduara duke përfshirë tregtimin e tyre në të gjithë gamën e llojshmërisë së tyre të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi;

Trasporti pér nevojat e shoqërisë dhe të tretëve ;

Kryerja e operacioneve me pasuri të palujtëshme: blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjetër të pasurive të palujtëshme në funksion të realizimit të qëllimeve shoqërore si dhe sipërmarrje të ndryshme, në përputhje me kërkkesat që burojnë nga ligjet në fuqi.

Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.

KAPITULLI III
Kapitali shoqëror-Kuotat
Neni 6-Kapitali shoqëror

Kapitali shoqëror është 100.000 (njëqindmijë) lekë, i ndarë në kuota sipas aktit të themelimit.

Neni 7-Kuotat

Çdo kuotë të jep të drejtën e një vote.

Bardhush Neshi  -1- Martin Lleshi M. Len

Neni 8-E drejta e pronsisë

Posedimi qoftë edhe i një kuote përbën në vetvehte pranimin e aktit të themelimit dhe të këtij statuti.

Neni 9-Trasferimi i kuotave

Kuotat e shoqërisë janë lirisht të trasferueshme midis ortakëve, duke respektuar të drejtën e parablerjes që çdo ortak mund të ushtrojë në përputhje me përqindjen e kuotës që ai posedon.

Kuotat e shoqërisë mund tu trasferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm kur Asambleja vendos me shumicën e ortakëve që përfaqsojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

Çdo ortak që dëshëron tu trasferojë të tretëve kuotën e tij ose pjesë të saj, duhet më parë tja ofrojë atë nëpërmjet një letër rekomandeje ortakëve të tjerë, të cilëve u takon e drejta e parablerjes ndaj së tërës, në përputhje me përqindjen e kuotave të tyre në kapitalin themeltar.

Oferta e blerjes duhet të përmbajë sasinë e kuotave që do të traferohen, çmimin përkatës dhe mënyrën e pagesës.

Kur jo të gjitha kuotat e ofruara blihen nga ortakët brenda tre muajve nga dita e ofertës, shitësi ka të drejtë t'i shesë të tretëve kuotat e pashitura, me kusht që çmimi i shitjes të mos jetë më i ulët se ai i kërkuar ortakëve.

KAPITULLI IV

Asamblea

Neni 10-Fuqitë e Asamblesë

Asembleja e thirur dhe e përbërë rregullisht, përfaqson têrësinë e ortakëve dhe vendimet e tyre, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut detyrojnë të gjithë ortakët, edhe në qofte jopjesmarrës apo që nuk janë dakort.

Neni 11-Modalitetet e thirrjes

Thirjet e Asamblesë bëhen nën kujdesin e një prej administratorëve

Bordluok Jleshë: *Jelly* -1- Martin Lleshë Milani

e në mungesë nga një apo disa ortakë që përfaqsojnë të paktën 10 për qind të kapitalit themeltar

Asembleja e thirur me formalitetet e ligjit mund të mbahet veç selisë së shoqërisë, edhe jashtë saj, në atë vend që do të tregohet në lajmërimin e thirjes.

Asembleja e zakonshme duhet të thirret së paku një herë në vit, brenda 4 muajve nga mbyllja e viti ushtrimor.

Sa herë që nevoja të veçanta e kërkojnë, Asambleja mund të vendosë një afat më të madh, por në asnjë rast mbi gjashtë muaj nga mbyllja e viti ushtrimor.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret për vendime të kompetencës së saj. Thirja e Asamblesë duhet gjithashtu të behet pa vonesë, kur është bërë kërkesë nga ortakët në bazë të ligjit.

Neni 12-Pjesmarrja dhe Delegimi

E drejta e pjesmarrjes në Asamble rregullohet nga dispozitat që përban neni 58 i Ligjit «Për Shoqëritë Tregtare» dhe nga dispozitat e tjera të ligjit.

Çdo ortak mund të përfaqesohet nga një ortak tjetër. Ai mund të përfaqsohet edhe nga një person jo ortak, por i takon atij që drejton Asamblenë të kostatojë rregullshmërinë e autorizimeve e të drejtën e pjesmarrjes në këto raste.

Neni 13-Drejtimi i Asamblesë

Presidenca e asamblesë i përket administratorit që ka ndërmarrë iniciativën për thirrjen e saj .

Asambleja emëron një sekretar, edhe jo ortak.

Neni 14-Vlefshmëria e Asamblesë

Asamblea e zakonshme vendos me votën e favorshme të një apo aq ortakëve që përfaqsojnë shumicën e kapitalit themeltar.

Në se nuk arrihet kjo shumicë, ortakët mblidhen për herë të dytë

Berdhok Jashi, *[Signature]* -1- Martin Leshi M. Leshi

dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqsojnë.

Për formimin ligjor të Asamblesë së jashtëzakonshme, si për të parën ashtu edhe për thirrjen e dytë dhe vlefshmërinë e vendimeve përkatëse, është përkatesisht e nevojshme pjesmarrja dhe vota pro e shumicës së ortakëve që përfaqsojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar.

Neni 15-Proçesverbalı

Vendimet e Asamblesë duhet të rezultojnë nga procesverbalı i firmosur nga Presidenti e nga Sekretari.

Proçesverbalı redaktohet nga noteri në rastet e parashikuara në ligj.

Neni 16-Administrimi

Shoqëria administrohet nga një administratorë.

Administratori I shoqerise " MILENIUM CONSTRUCTION" Sh.p.k eshte zgjedhur Z. Bardhok Lleshi.

Për shitjen e pasurive që përbëjnë kapitalin shoqëror apo hyjnë në aktivin e shoqërisë, duhet vendimi I asamblese se ortakeve.

Neni 17-Delegimi i fuqive(kompetencave)

Administratori mund t'i delegojë atributet e tij, duke përcaktuar caqet e delegimit:

- një Drejtori të Përgjithshëm ose komerçal.

Neni 18-Fuqitë e Organit Administrativ

- fuqitë (të drejtat) për administrimin e aktivitetit të shoqërisë dhe për përbushjen më së miri të objektit shoqëror;
- mbikqyrjen e kontrollin e aktivitetit e të pasurisë së shoqërisë, me të drejtën e kryerjes së të gjitha operacioneve dhe akteve që çmohen të nevojshme për përbushjen e objektit shoqëror brenda caqeve të përcaktuara nga Asambleja, duke përjashtuar vetëm ato që ligji e statuti ja rezervojnë asamblesë së zakonshme apo të

Zardhok Lleshi -1- *Martin Lleshi M-Len*

- jashtëzakonshme;
- përfaqson shoqërinë para të tretëve duke respektuar objektin shoqëror, autoriteteve gjyqsore, administrative e noteriale;
 - fuqitë për organizimin e shoqërisë me të drejtën e krijimit e rregullimit të zyrave të ndryshme (përfshirë Drejtorë, teknikët e nëpunësit), duke përcaktuar funksionet e të drejtat, krijuar e suprimuar organe konsultative.

Neni 19-Përfaqsimi i shoqërisë

Përfaqsimi i shoqërisë i përket në vijë të përgjithshme e pakufizime, Administratorit.

Përfaqsimi i shoqërisë i përket gjithashtu:

-përfaqqsuesve të posaçëm, që mund të emërohen për akte apo kategori aktesh të veçanta, nga të gjithë subjektet e treguar në këtë nen, secili brenda të drejtave të tij.

Neni 20 - Shpërblimi i administratorit.

Administratorit i përket kompësimi për shpenzimet e kryera pëarsye të zyrës si dhe një shpërblim, që mund t'ju përcaktohet nga asambleja e zakonshme me vendim të vlefshëm deri në ndryshimin e tij.

KAPITULLI V

Kontrolli i shoqërisë

Neni 21-Ekspertët kontabël të autorizuar

Asambleja e zakonshme emëron në rastet e parashikuara nga neni 65 i Ligjit 7638 një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar. Shpërblimi i tyre përcaktohet nga asambleja në aktin e emërimit.

KAPITULLI VI

Bilanci

Neni 22 - Viti ushtrimor

Viti ushtrimor mbyllt më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 23 - Bilanci

Në fund të çdo viti organi administrativ merr masa në përputhje me urdhërimet e ligjit, për kryerjen e bilancit të shoqërisë.

Barolliolc Lleshi Jler -1- Martin Lleshi M. Iem

Neni 24 - Fitimet

Fitimi neto i bilancit ndahet si vijon:

- 5% (pesë përqind) destinohet për rezervën lrigore deri sa ajo mos tē ketë arritur një tē dhjetën e kapitalit shoqëror, si dhe kur rezerva ka zbritur nën këtë shumë, deri në riplotësimin e saj;
- pjesë e mbetur do tē ndahet sipas vendimeve të asamblesë.

KAPITULLI VII

Dispozita të përgjithshme

Neni 25 - Zgjidhja e likuidimi

Aktiviteti pushon dhe shoqëria zgjidhet, kur:

- përfundon afati i kohëzgjatjes së vendosur;
- pamundësia për tē mbuluar humbjet e shoqërisë nga ana e tē gjithë ortakëve, në përputhje me kuotat shoqërore që ata posedojnë;
- në çdo rast me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme që do tē emërojë një ose më shumë likuidatorë duke fiksuar tē drejtat e shpërblimin.

Neni 26 - Klauzola e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Cdo mosmarrëveshje që mund tē lindë rrëth vlefshmërisë, interpretimit dhe ekzekutimit të kësaj kontrate, do ti besohet vendimit të Gjykatës së vendit ku shoqërija ushtron aktivitetin në përputhje me legislacionin në fuqi.

Neni 27- Referim

Për gjithçka sa nuk është parashikuar zbatohen normat e Kodit Civil dhe ligjet e tjera tē fushës përkatëse.

ORTAKËT

Bardhok Lleshi

Bardhok Lleshi


Martin Lleshi

Martin Lleshi
M. Lleshi

KERKESE

A circular black ink stamp. The outer ring contains the text "REPUBLIC OF MACEDONIA" at the top and "SKOPJE" at the bottom. In the center, it says "18 MAR." above "1998". There is some faint, illegible text or a signature in the middle.

M. Depp
18 03 2002
2002 film

KERKUES : Bardhok Lleshi I biri I Prenges dhe I Terezes lindur ne Puke me 02.08.1970 , banues ne Tirane Rr."Mihal Grameno", perballë miniBashkise.

OBJEKTI :Kerkohet rregistrimi si person juridik I shoqerise
"MILENIUM CONSTRUCTION" SH.P.K

Baza ligjore :Ligji Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare "

PULLE TAKSE	RANE
100 LEKE RASHOPERISE	100 LEKE RASHOPERISE
PULLE TAKSE	PULLE TAKSE
100 LEKE RASHOPERISE	100 LEKE RASHOPERISE
PULLE TAKSE	PULLE TAKSE

Midis meje Bardhok Lleshi dhe Martin Lleshi eshte rene dakort te krijojne nje shoqeri me pergiegesi te kufizuar

Per te themeluar shoqerine ne kemi hartuar kontraten e themelimit , ashtu statutin e shoqerise te cilat I kemi nenshkruar rregullisht ne prani te noterit

Shoqeria do te kete emrin "MILENIUM CONSTRUCTION "Sh.p.k

Selia e shoqerise do te jetë ne Tirane , Rr."Mihal Grameno "perballë mini Bashkise.
Kapitali I saj eshte 100.000 leke, pjeset e te cilit jane nenshkruar dhe shlyer krejtësisht ne banke (neni 40 I ligjit).

Objekti I shoqerise eshte :

Ndertime civile dhe ekonomike

- Ndertime civile, industriale , turistike , buqesore , e te tjere , mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to

Prodhime Materiale ndertimi

- a) Prodhim materiale inerte , rere cakull , gure , mermer etj.
 - b) Prodhim qeramike si tulla tjegulla, fajance , gres.
 - c) Prodhim elementesh te parafabrikuara , betoni e b/arne.
 - d) Prodhim elemetesh te parendur dhe armocementi

- e) Prodhim materiale lidhese çimentoje , gelqereje, allçi etj.
- Prodhime materiale bituminoze si kartone, katrama, pasta, astika bituminoze, asfalto betone etj.
- g) Prodhime druri metalike, plastike etj, per dyer , dritare, kallepe, etj.

Punime restaurimi

- a) Rikonstruksione godinash civile e ekonomike , veshje fasadash etj.
- b) Restaurim I monumenteve te kultures .

Punimet e montimit dhe teknologjike

- Montimi dhe instalimi I makinerive dhe impianteve ngritesë e transportuese (vinça ,teleferike , transportiere , shkalle levizese , ashensore etj) dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike , kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre .
- Montimi dhe instalimi I impianteve pneumatike te sigurimit te kontrollit (KIP) dhe mirembajtja e tyre .
- Punime me metal , dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike.
- Punime bojatisje ,hidroizolimi, termoizolimi , akustike e kundra zjarrit te impianteve teknologjike .
- Montimi dhe instalimi I impianteve te gazit dhe I eneve me presion si dhe mirembajtja e tyre .

Punimet e montimit ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.

- Impiante per prodhim energjie alternative, impiante elektrike per n\stacionet dhe kabinet e transformatoreve , impiante dhe linja elektrike, telefoni, radio-telefoni, televiziv, citofoni, dhe mirembajtjen e tyre, linja te tensionit te larte(TL) , linja te tensionit te ulet (TU) e te mesem , aparatura elektrike dhe mirembajtja e tyre , punime kolaudimi per pajisjet primare e sekondare elektrike dhe per kolaudime mekanike per n\stacione dhe centrale elektrike .

Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtje .

- Punime ne siperfaqet e gjelberta , parqe ,pyll.- pastrimi I siperfaqes urbane ,- kryerja e punime ne sherbesa funerale, - mirembajtja dhe zhvillimi I dekorit ne mjedise urbane .

Prodhimin e artikujve të veshmbathjes e të tjera të ngjashme, të të gjitha llojeve e cilësive, pa kufizim destinacioni, për llogari të saj apo tip fason .

Te gjitha keto aktivitete shoqeria do t'i kryej me materiale te saj dhe jo te saj .

Importimin e tregtimin e lendeve te para e prodhimeve te perfunduara duke përfshirë tregtimin e tyre në të gjithë gamën e llojshmërisë së tyre të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi; trasporti për nevojat e shoqërisë dhe të tretëve ; kryerja e operacioneve me pasuri të palujtëshme: blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjetër të pasurive të palujtëshme në funksion të realizimit të qëllimeve shoqërore si dhe sipërmarrje të ndryshme, në përputhje me kërkesat që burojnë nga ligjet në fuqi. Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.

Per te fituar personalitetin juridik te shoqerise " MILENIUM CONSTRUCTION" Sh.p.k , Kerkoj :

Rregjistrimin e shoqerise " MILENIUM CONSTRUCTION" Sh.P.K


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË
Nr. 994 rep. = kol.




V E R T E T I M

KERKUESI
Bardhok Lleshi
Bardhok Lleshi

Sot më datën, 14 Mars 2008 para meje Noterit Ylli Mahmuda , i regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Bardhok Preng Lleshi, lindur ne Puke me 02.08.1970, banues ne Tirane , Rrug. "M. Grameno "perballë mini Bashkise, shtetas shqiptar , me numër pasaporte 1692954; madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumentat identifikuase sa sipër, i cili nënshkroi në prezencën time Kerkesen per rregjistrimin e Shoqerise dhe unë noterie vertetoj rregullisht konform ligjit.



27430/1



KERKESE

KERKUES: Edison Prendi, I biri I Ndreeses dhe I Dranes, 7.05.1979

OBJEKTI: Kerkohet depozitimi I Vendimit nr 1 dt 20.02.2004 te mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te shoq "Milenium Construcion" shpk., ne Mbeshtetje te ligjit nr 7638 dt 19.11.1992 dhe 7667 dt 28.01.1993

(1) *Bëu depoziti i vendimit nr 1 dt 25.02.2004 te mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te shoq "Milenium Construcion" shpk. ne Mbeshtetje te ligjit nr 7638 dt 19.11.1992 dhe 7667 dt 28.01.1993*

PERPARA
GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Me vendimin nr 27430 dt 21.03.2002 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane eshte regjistruar si person juridik shoq "Milenium Construcion" shpk.

Me vendimin nr 1 dt 25.02.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoq "Milenium Construcion" shpk eshte vendosur:

1. Largimin nga detyra e administratorit Z.Bardhok Lleshi te shoq "Milenium Construcion" shpk.
